V E N D I M
Nr. 26, datë 4.1.1991

PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE NGA ARBITRAZHI SHTETËROR"

Me propozimin e Arbitrazhit Shtetëror, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Rregullores për shqyrtimin e çështjeve nga arbitrazhi shtetëror"
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.178, datë 24.10.1973, për miratimin e rregullores për shqyrtimin e e mosmarrëveshjeve nga Arbitrazhi Shtetëror shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI

RREGULLORE
PËR SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE NGA ARBITRAZHI SHTETËROR

Me qëllim që të mbrohen të drejtat civile dhe të zbatohen me përpikmëri ligjet në zgjedhjen e mosmarrëveshjeve pasurore parakontraktore e kontraktore, Këshilli i Ministrave, në pajtim me nenin 35 të ligjit "Për Arbitrazhin Shtetëror", miraton këtë rregullore.

KREU I
PARIMET DHE RREGULLAT E PRANIMIT TË ÇËSHTJEVE NË ARBITRAZH

Neni 1

Ndërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore, kooperativat, personat juridik a fizikë të huaj a shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, kur nuk arrijnë t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet pasurore që lindin ndërmjet tyre nga mosekzekutimi ose ekzekutimi jo në mënyrën e duhur të detyrimeve kontraktore, i drejtohen arbitrazhit.

Neni 2

Organet e arbitrazhit shqyrtojnë edhe mosmarrëveshjet pasurore parakontraktore, kur detyrimi për lidhje kontrate buron nga akti i planifikimit, pasi të jenë përcaktuar më parë nga organet e emërtesës sasia lloji, cilësia dhe ambalazhimi i mallit.

Kërkesëpadia në këtë rast duhet të parashtrojë edhe arsyet pse kushtet e propozuara nga pala e paditur janë të pabazuara.

Neni 3

Zgjidhja e mosmarrëveshjes parakontraktore e kontraktore bazohet në detyrat e planit të shtetit për kontratat që janë lidhur ose duhet të lidhen, në pajtim me aktin e planifikimit

Rregullat e pranimit të çështjeve në arbitrazh

Neni 4

Kërkesëpadia që i drejtohet arbitrazhit, duhet të shqyrtohet me dokumentet e nevojëshme, siç parashikohet në nenin 13 të ligjit si dhe me aktet ligjore e nënligjore të pabotuara që lidhen me

veprimtarinë dhe detyrimet e ndërsjella të palëve.

Kërkesat e ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, të prokurorit dhe të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve pranohen pa këto dokumente. Në këto raste arbitrazhi përcakton vetë se çfarë dokumentesh duhet të merren e të administrohen.

Neni 5

Ndërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore, kooperativat bujqësore janë të detyruara që, para se ta paraqesin çështjen për zgjidhje në arbitrazh, të bëjnë rakordimet dhe barazimet e llogarive, duke përpiluar akt të përbashkët e duke përfshirë edhe vërejtjet e veçanta që mund të kenë.

Nëse palët nuk pranojnë të përpilojnë akt të përbashkët, telegrami ose teleksi i anës paditëse zë vendin e rakordimit.

Padia, si rregull, ngrihet brenda muajit nga data e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit.

Neni 6

Nërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore, kooperativat, me të marrë kërkesëpadinë, i dërgojnë menjëherë arbitrazhit dhe palës paditëse përgjigje me shkrim, duke argumentuar kundërshtimet e prapësimet lidhur me kërkesëpadië; përgjigjes i bashkëngjiten edhe dokumentet e nevojëshme.

Kur pala e paditur nuk dërgon përgjigje me shkrim dhe, nga ana tjetër, nuk paraqitet, arbitrazhi fillon shqyrtimin në bazë të dokumenteve që ka paraqitur ana paditëse.

Veprimet që kryen arbitri i vetëm

Neni 7

Arbitri i vetëm kryen këto veprime:

Verifikon nëse dokumentet janë të plota, veçanërisht nëse është i qartë objekti i mosmarrëveshjes, vlefta e detyrimit të paekzektuar, shuma e kushtit disiplinor të kërkuar, dëmi i ardhur, shkaqet që e kanë lidhur mosmarrëveshjen, si dhe provat mbi të cilat mbështetet. Kur vëren se kërkesëpadia nuk i plotëson kushtet, ajo mbetet pa veprim dhe njofton paditësin me shkresë, duke i caktuar një afat 10-ditor nga dita e mbërritjes së njoftimit, për të plotësuar të metat. Me kalimin e këtij afati kërkesëpadia quhet e paraqitur dhe i kthehet paditësit, së bashku me aktet.

Kur të metat e kërkesëpadisë janë plotësuar brenda afatit të caktuar, për efekt parashkrimi, ajo quhet se është pranuar qysh nga dita që është paraqitur.

- Verifikon legjitimimin aktiv e pasiv dhe thërret personat e interesuar.
- Vendos nëse çështja hyn në juridiksionin dhe kompetencën e arbitrazhit; kur çështja nuk hyn në juridsionin dhe kompetencën e arbitrazhit; kërkesëpadia së bashku me aktet, u dërgohet organeve përkatëse.
- Kur për zgjidhjen e çështjeve janë të interesuara ndërmarrje, institucione a kooperativa, i thërret këto si palë të interesuara.
- Në rastet kur zgjidhja e çështjes kërkon njohuri të posaçme, urdhëron kryerjen e ekspertimit, duke caktuar si ekspertë specialistë të degëve përkatëse; përcakton pyetjet që duhet t'u përgjigjet ekspertit, si dhe afatin kur duhet të përfundojë ekspertimi dhe i njofton për këtë palët.
- Vendos bashkimin ose ndarjen e çështjeve, kur kërkesëpadia u drejtohet shumë të padituve, ose janë parashtruar shumë kërkime për çështjte që kanë lidhje ndërmjet tyre, si dhe kur shqyrtohen çështje, në të cilat marrin pjesë po ato ndërmarrje, institucione a kooperativa si paditës e të paditur për çështje që kanë lidhje me ndërmarrjet.

Plani i shqyrtimit të çështjes

Neni 8

Për çështje kryesore arbitri harton planin e shqyrtimit të tyre, ku përcaktohen sidomos;

- Masat me karakter organizativ, siç janë caktimi i personave që do të marrin pjesë dhe vendi

ku do të shqyrtohet çështja.

- Problemet me karakter ekonomik e shoqëror që do të trajtohen, si faktorët që kanë kushtëzuar shkeljen e deyrimeve, dëmi i ardhur, masat për parandalimin e shkeljeve të ligjit etj.

- Problemet me karakter ligjor, si dispozitat materiale e procedurale ku mbështetet kërkesa, aktet e tjera nënligjore dhe karakteri i kontratës.

Shqyrtimi i çështjes

Neni 9

Arbitri i vetëm, pas sqarimit të problemeve, merr vendim me shkrim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë, duke caktuar ditën, vendin, orën për shqyrtim, të mosmarrëveshjes, provat që do të administrohen, dhe njofton për këtë palët.

Neni 10

Përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes, kryetari i njeh palët me përbërjen e kolegjit dhe i pyet nëse kanë ndonjë vërejtje.

Kur palët ose njëra prej tyre nuk janë të një mendimi me përbërjen e kolegjit, zbatohen kërkesat e nenit 15/2 të ligjit "Për Arbitrazhin Shtetëror"

Kolegji i arbitrazhit, pasi vëren se palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë paraqitur dhe çështja hyn në kompetencën e arbitrazhit, fillon shqyrtimi me një paraqitje të shkurtër të kërkesës dhe i fton palët ose përfaqsuesit e tyre të paraqesin provat, kërkesat dhe prapësimet që kanë për mosmarrëveshjen.

Dokumentet kryesore ose kopjet e tyre lexohen dhe, pasi shqyrtohet shkurt përmbajtja e tyre në procesverbal, i bashkëngjten dosjes, ose u kthehen palëve.

Neni 11

Mendimet e ekspertëve paraqiten me shkrim, por kolegji, vetë ose me kërkesën e palëve, ka të drejtë t'i thërrasë për të dhënë shpjegime plotësuese. Ekspertët mund të thërrasin palët në vendin e ekspertimit dhe të kërkojnë prej tyre informata, sqarime e dokumente të nevojshme për kryerjen e ekspertimit.

Ekspertët shpërblehen për punën që bëjne, dhe masa e këtij shpërblimi caktohet nga kolegji i arbitrazhit, sipas vëllimit dhe karakterit të ndërlikuar të ekspertimit, brenda tarifave të caktuara.

Neni 12

Çështjet në arbitrazh i përfaqsojnë drejtuesit e ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave a kooperativave, avokatët ose përfaqsuesit e tjerë të pajisur me autorizim me shkrim të cilët kanë kompetencë sikur të ishin vetë titullarët. Shpjegimet e bëra në seancë çmohen së bashku me të gjitha povat dhe rrethanat e çështjes.

Pyetja e personave që nuk dinë gjuhë shqipe, bëhet në prani të përkthyesit. Faktet e njohura botërisht, ose kur për to ekziston prezumimi ligjor, nuk ka nevojë të provohet.

Neni 13

I padituri mund të bëjë kundërpadi, e cila paraqitet derisa nuk ka përfunduar shqyrtimi i mosmarrëveshjes. Kundërpadia parashtrohet sipas rregullave të caktuara për ngritjen e padisë.

Kur vlera e kundërpadisë i kalon kufijtë e kompetencës, padia dhe kundërpadia i dërgohen për shqyrtim organit të arbitrazhit, në kompetencat e të cilit hyn vlefta e kundërpadisë.

Neni 14

Kur palët bien dakort ta zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim dhe ky nuk vjen në kundërshtim me ligjin, me primet e përgjithshme të politikës ekonomike të shtetit, kolegji i arbitrazhit e miraton

pajtimin duke hartuar procesverbal për kushtet e pajtimit.

Procesverbali nënshkruhet nga përfaqsuesit e palëve që kanë autorizim të posaçëm, si dhe nga kolegji i arbitrazhit.

Neni 15

Për çështje të rëndësishme kryetari i arbitrazhit pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose kryetari i Arbitrazhit shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, vetë ose më kërkesën e palëve, cakton kolegj të përbërë nga tre arbitra ose nga dy arbitra e tre ndihmësarbitra.

Ndihmësarbitrat shkëputen 15 ditë në vit dhe paguhen nga qëndra e tyre e punës, kundrejt vërtetitmit të lëshuar nga arbitrazhi përkatës.

Arbitrat jofunksionarë, kur kryesojnë kolegjin, në marrëveshje me qëndrën e tyre të punës, marrin honorare sipas tarifave të miratuara.

Neni 16

Kur kolegji i arbitrazhit çmon se çështja është sqaruar plotësisht, i jep fund shqyrtimit të mosmarrëveshjes, kur para shpalljes së vendimit palët a pjesmarrësit në proçes paraqesin prova të reja, ose tregojnë rrethana të tjera që kanë rëndësi për çështjen, si dhe kur në kohën e bisedimit të vendimit lind nevoja për të sqaruar probleme të tjera të rëndësishme.

Neni 17

Kolegji që shqyrton çështjen, me kërkesën e të interesuarit, mund ta heqë gjobën prej 100 lekësh, dhënë për mosparaqitje ekspertit ose personave të thirrur.

Neni 18

Në seancë mbahet procesverbal, ku pasqyrohet përbërja e kolegjit të arbitrazhit, vendi, dita, muaji i fillimit dhe i mbarimit të shqyrtimit të çështjes, emri, mbiemri dhe puna që bëjnë personat që marrin pjesë, kërkesat e palëve e të pjesëmarrësve të tjerë në proces; procesverbali nënshkruhet nga sekretari i seancës deh kryetari i kolegjit.

KREU II

RREGULLA TË VEÇANTA TË SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJES, KUR NJËRA PALË ËSHTË PERSON JURIDIK OSE FIZIK I HUAJ A SHQIPTAR NË SELI JASHTË TERRITORIT TË RPSSH.

Neni 19

Shqyrtimi i çështjes, kur njëra nga palët është person juridik, fizik i huaj a shqiptar me seli jashte territorit të RPSSH, që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, fillon vetëm me kërkesëpadi, ku parashtrohen çështjet që kërkohet të zgjidhen nga arbitrazhi.

Neni 20

Kërkesëpadia shoqërohet me dokumentet e tjera shkresore, të nevojshme të mbështetin pretendimet e palës paditëse për mosekzekutim ose ekzekutim jo në mënyrën e duhur të detyrimit kontraktor nga pala e paditur, kopjen e kontratës a të marrveshjes tjetër me shkrim, ku palët kanë pranuar zgjidhjen e çështjes nga arbitrazhi.

Neni 21

Kur njëra nga palët është person juridik ose fizik i huaj a shqiptar me seli jashtë territorit të

RPSSH, edhe kur nuk është parashikuar në kontratë zgjidhja e çështjes në arbitrazh, pas lindjes së mosmarrëveshjes dhe në pamundësi për ta zgjidhur atë në rrugë të tjera, mund të bihet dakort me shkrim që për zgjidhje t'i drejtohen arbitrazhit.

Rregullat e caktimit të arbitrit

Neni 22

Palët që janë persona juridikë ose fizikë të huaj a shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH e që kryejnë investime a zhvillojnë veprimtari ekonomike të përbashkët në RPSSH, kanë te drejtë të shënojnë në kontratë emrin e arbitrit ose të arbitrave që do të shqyrtojnë çështjen e që janë emëruar si arbitra të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave .

Palët kanë te drejtë të caktojnë secila një deri në dy aritra.

Neni 23

Kur në kontratë është caktuar një arbitër, ai fton palët për të caktuar secila nga një ndihmësarbitër nga lista e ndihmësarbitrave të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Kur palët nuk kthejnë përgjigje brenda 5 ditëve, ndihmësarbitrat që do të marrin pjesë ne kolegj caktohen nga arbitri i zgjedhur nga palët në kontratë e në marrëveshje tjetër me shkrim.

Kur palët kanë caktuar secila nga një ose dy arbitra, këta detyrohen të merren vesh me shkrim brenda 5 ditëve për caktimin e arbitrit që do të kryesojë kolegjin. Kur me kalimin e këtij afati arbitrat e secilës palë nuk janë marrë vesh, kryesuesin e cakton kryetari i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Kur në kontratë a në marrëveshje tjetër me shkrim nuk është caktuar arbitri ose arbitrat që do të shqyrtojnë çështjen për shkaqe të përligjura, kryetari i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesëpadisë, fton palët të caktojnë arbitrin ose arbitrat që do të shqyrtojnë çështjen. Pas kalimit të këtij afati kolegji caktohet nga kryetari i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Shqyrtimi i çështjeve

Neni 25

Menjëherë pas caktimit, kolegji i arbitrazhit, me qëllim që të sigurojë një zgjidhje të shpejtë e të drejtë të çështjes, i dërgon palës së paditur relacionin me shkrim, ku përfshihen çështjet që janë ngritur për t'u zgjidhur, dhe një përmbledhje të dokumenteve të paraqitura, duke i kërkuar që brenda 15 ditëve të japë mendime me shkrim, duke argumentuar kundërshtimet dhe prapësimet lidhur me kërkesëpadinë;

Përgjigjes i bashkëlidhen edhe dokumentet e nevojshme.

Kur ana e paditur nuk dërgon përgjigje me shkrim dhe, nga ana tjetër, nuk paraqitet në seancë, kolegji e shqyrton çështjen në bazë të dokumenteve që ka paraqitur pala paditëse.

Neni 26

Kolegji i arbitrazhit, kur vëren se çështja është në kompetencën e tij dhe dokumentet janë të mjaftueshme, cakton ditën, vendos orën e shqyrtimit dhe i fton palët të paraqesin edhe provat e tjera që kanë, për të mbështetur pretendimet ose prapësimet lidhur me kërkesat që ka bërë paditësi.

Kur njëra nga palët nuk është paraqitur në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, shqyrtimi i çështjes zhvillohet në munges të saj, kurse kur nuk është paraqitur asnjëra nga palët, kolegji vendos pushimin e çështjes.

Neni 27

Kolegji i arbitrazhit, kur vëren se provat e paraqitura janë të pamjaftueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, fton palët dhe pjesmarrësit e tjerë që të paraqesin, nëse kanë prova të tjera.

Me kërkesën e palëve ose të pjesmarrësve të tjerë të interesuar për zgjidhjen e çështjes, kolegji i arbitrazhit urdhëron të kryhen ekspertime. Për ekspertët dhe çështjet që duhet të zgjidhen, merret mendimi i palëve ose i pjesmarrësve të tjerë të interesuar që e kanë kërkuar ekspertimin.

Neni 28

Në shqyrtimin e çështjes, kur njëra nga palët është person juridik a fizik i huaj a shqiptar me seli jashtë territorit të RPS të Shqipërisë, që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, përdoret gjuha shqipe, ose gjuha e pranuar nga palët në kontratë a në marëveshje me shkrim, duke caktuar përkthyes.

Neni 29

Palët që janë persona juridikë ose fizikë të huaj a shqiptarë me seli në RPSSH, në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes kanë të drejtë të heqin dorë nga kërkesa, ose ta zgjidhin çështjen me pajtim.

Heqja dorë dhe pajtimi shënohen në procesverbal dhe nënshkruhen prej tij. Kolegji i arbitrazhit, kur vëren se heqja dorë dhe pajtimi nuk bien në kundërshtim me ligjin, pushon çështjen dhe u ngarkon palëve shpenzimet e bëra deri në këtë fazë.

KREU III
SHPALLJA E VENDIMIT, MASAT PARANDALUESE, KËRKESA PËR MBROJTJE LIGJSHMËRIE, ANKIMI ETJ.

Shpallja e vendimit

Neni 30

Në përfundim kolegji jep vendim për zgjidhjen në themel të çështjes, duke u bazuar në ligjet dhe në çmimin që u bënë provave pas shqyrtimit në tërësi të tyre.

Vendimi shpallet nga kryesuesi i kolegjit dhe, pas shpalljes, kolegji që e ka shqyrtuar çështjen, nuk mund të ndryshojë ose të shfuqizojë atë .

Vendimi shpallet në prani të palëve; për çështje të ndërlikuara shpallja e vendimit mund të shqyrtohet jo më shumë se 5 ditë, me kusht që palëve, kur janë të pranishme, t'u njoftohet dita dhe ora e shpalljes së vendimit.

Neni 31

Kolegji i arbitrazhit, kur çmon të vërë detyra për plotësimin me përparësi të detyrimit, cakton masa të përkohëshme në vendim dhe ua dërgon palëve, pa e zgjidhur çështjen në themel. Me kalimin e afatit thërret palët dhe, pasi administron provat e tjera të nevojshme, jep vendim përfundimtar.

Neni 32

Pas shpalljes së vendimit kolegji i arbitrazhit që e ka shqyrtuar çështjen, me kërkesën e palëve, para se vendimi të jetë zbatuar, ndreq gabimet materiale, si përllogaritje gabimi të shumave, mospërputhje të pjesës arsyetuese me pjesën urdhëruese të vendimit dhe shënimin gabim të emrave që e kanë përfaqsuar çështjen.

Ndreqja e gabimeve materiale bëhet me vendim, nënshkruhet nga arbitrat dhe i bashkëngjitet dosjes.

Masat parandaluese

Neni 33

Kolegjet e arbitrazhit, kur vërejnë raste të shkeljes së ligjit e të kontratave që kanë ndikuar në

moslidhjen e në mosplotësimin e detyrave kontraktore, marrin vetë masa gjobitjeje ndaj personave fajtorë, si dhe bëjnë kërkesa për masa materiale disiplinore e administrative.

Neni 34

Kur në veprimtarinë e ndërmarrjeve, të institucioneve e organizatave, kolegji gjatë shqyrtimit të çështjes vëren të meta dhe mungesa të rëndësishme që kanë ndikuar në shkeljen e detyrimeve, bashkë me vendimin përfundimtar, merr vendim të veçantë, me anë të të cilit kërkon të merren masa konkrete.

Neni 35

Kërkesat për mbrojtje ligjshmërie dhe ankimet ndaj vendimeve përfundimtare u njoftohen palëve dhe shqyrtohen nga mbledhja e përgjithshme e Arbitrave Shtetërorë pranë këshillit të Ministrave, brenda dy muajve nga paraqitja e kërkesës ose e ankesës.

Shqyrtimi fillon me relatimin e njërit prej arbitrave të arbitrazhit shtetërorë pranë Këshillit të Ministrave, ku jepen shkurt përmbajtja e vendimit, prova mbi të cilat është mbështetur ligji dhe kontratat ku është bazuar vendimi, shkaqet që ngrihen në kërkesën ose në ankesën dhe mendimi i tij për çështjen.

Mbledhja e përgjithshme e arbitrave për Arbitrazhin Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave mund të dëgjojë drejtpërsëdrejti shpjegimet e palëve lidhur me vendimin e kolegjit.

Diskutimet dhe provat e paraqitura shënohen në procesverbal.

Vendimet jepen me shumicë votash.

Neni 36

Ekzekutimi i vendimeve

- Ekzekutimi i vendimeve për detyrimet në të holla ndaj ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave dhe organizatave shoqërore bëhet nga banka, mbi llogarinë e debitorit dhe në masën e nevojëshme të plotësimit të detyrimit.

- Ekzekutimi i detyrimeve ndaj personave juridikë ose fizikë të huaj a shqiptarë u dërgohen bankave, ku është derdhur kapitali për investime ose veprimtari ekonomike të përbashkët.

- Gjobat personale dërgohen zyrave të financës të qëndrës së punës të personave fajtorë ose zyrave të përmbarimit sipas caktimit që bëhet në urdhër ekzekutimin nga arbitrazhi shtetëror .

- Urdhri për kryerjen e punimeve a dorëzimin e objektit, sipas rastit, u dërgohet komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve a të rajoneve, ndërmarrjeve, institucioneve të ndryshme dhe kooperativave.

Urdhri i ekzekutimit nënshkruhet nga kryetari i arbitrazhit ose zëvendësi i tij dhe i dërgohet bankës, zyrave të financës dhe të përmbarimit, komiteteve ekzekutive ose intitucioneve të tjera brenda 10 ditëve nga dita e dhënies së vendimit.

- Vendimet e dhëna në favor të personave juridikë ose fizikë të huaj a shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH vihen në zbatim prej tyre me anë të kopjes së vendimit të vertëtuar nga sekretaria e arbitrahit.

Shpenzimet e arbitrazhit

Neni 37

Në shpenzimet e arbitrazhit përfshihen:

- Tarifat për shqyrtimin e çështjes, parapagimi i të cilës i bashkëngjitet kërkesëpadisë.
- Shpenzimet për personat e thirrur, për ekspertët dhe për këqyrjen .
- Honoraret për arbitrat jofunksionarë.

Neni 38

Tarifat dhe shpenzimet e tjera caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave e

të kryetarit të Arbitrazhit të Shtetit pranë Këshillit të Ministrave dhe derdhen në buxhetin e shtetit.

Kur njëra nga palët është person juridik ose fizik i huaj a shqiptar jashtë territorit të RPSSH që kryen investime ose zhvillon veprimtari ekonomike në RPSSH, pagesa bëhet në lekë ose në valutë të huaj, sipas kursit të caktuar nga Ministria e Financave.

Neni 39

Shpenzimet e arbitrazhit i ngarkohen palës, për fajin e së cilës zgjidhet mosmarrëveshja. Kur çështja përfundon me pajtim ose me heqje dorë, shpenzimet mbeten në ngarkim të secilës palë që i ka bërë, veç rasteve kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 40

Organet e arbitrazhit, për rregulla të tjera që nuk parashikohen në këto rregullore, zbatojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.